

**AKTI I THEMELIMIT**  
**DHE**  
**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**SH. P.K.**

Në bazë të ligjit 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (këtu e në vijim referuar si LSHT), nënshkruesit e këtij dokumenti, vendosën si më poshtë vijon:

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

1. Hartimi i Aktit të themelimit dhe Statutit bazohet dhe respekton kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (këtu e në vijim referuar si LSHT) dhe legjislacionit civil në fuqi.
2. Dispozitat e Statutit kanë karakter të detyrueshëm dhe rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërisë me Ortakët dhe organet e saj si dhe marrëdhëniet mes ortakëve. Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë dokument, rregullohen sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit shqiptar.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

1. Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
  - a) **“Shoqëria”** nënkupton shoqërinë tregtare të themeluar sipas këtij dokumenti, me emrin e përcaktuar në nenin 4 të këtij Statuti dhe të ndryshuar sipas rastit, në përputhje me kërkesat e Statutit dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.
  - b) **"Statuti"** nënkupton statutin e Shoqërisë.
  - c) **"Ortak(ët)"** Sipas rastit, themeluesit e Shoqërisë ose personat fizikë dhe/ose juridikë që zotërojnë kuotat e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e këtij Statuti;
  - d) **"Person"** është çdo person fizik apo juridik;
2. Në këtë Statut, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe, shprehjet në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, dhe gjinia mashkullore përfshin edhe atë femërore dhe anasjelltas.

**Neni 3**  
**Komunikimet**

1. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikime që Shoqëria i drejton Ortakëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit (ëve) të Shoqërisë duke përfshirë dhe komunikimet me mjete elektronike nëse këto të fundit garantojnë konfirmimin e marrjes dhe sigurinë e komunikimit.
2. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikimet e dërguara sipas paragrafit të mësipërm, do të konsiderohen rregullisht të marra nga Ortaku në datën më të hershme midis: (i) datës së marrjes efektive nga Ortaku, (ii) datës së pranimit apo refuzimit të shënuar në njoftimin e marrjes nëse dërgohet me postë të regjistruar; ose (iii) brenda 72 orësh nga dorëzimi pranë një shërbimi të shpejtë postar të njohur ndërkombëtarisht.

**KAPITULLI II**  
**THEMELIMI**

**Neni 4**  
**Data e themelimit, Themeluesit dhe Emri**

1. Sot, më datë **24/06/2021**, ne themeluesit, krijojmë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.
2. Emri i shoqërisë është **ALRES Energy 2 Sh.p.k**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin **ALRES Energy 2 Sh.p.k.** (këtu e në vijim: "Shoqëria"). Ndryshimi i emërimit të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
3. Themeluesit e Shoqërisë janë:
  - Z. Hekuran BRAHIMAJ**, i biri i Rystem, lindur në Katundisht, Përmet, më 13.08.1972 dhe banues në Rr. "Kodra e Bukur 15", Vorë, shtetas shqiptar, identifikuar me kartën e identitetit nr. 031162491, me nr.personal H20813103N madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
  - Z. Sefer Selim ERDEM**, i biri Muhammed Ridvad, lindur më 21.05.1961, banues në Rr. "Shahin Krasniqi. Nr. 23", Vushtrri, Kosovë, shtetas turk, identifikuar me kartën e identitetit nr. A18147585 me nr.personal 10123302394, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
  - Z. Fikret BANGU**, i biri i Orhan, lindur në Vushtrri, Kosovë, më 23.02.1973, banues në Rr. "Marin Barleti nr.45", Vushtrri, Kosovë, identifikuar me kartën e identitetit nr. ID1087706 me nr.personal 1001761109, shtetas kosovar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
5. Themeluesit e shoqërisë deklarojnë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, pranimin e dispozitave dhe parashikimeve që vijnë, hartimin e Akt themelimit -Statutit të shoqërisë së re

sipas të drejtës shqiptare, **ALRES Energy 2 sh.p.k.** mbi bazën e ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe hartojnë këtë Statut si vijon:

**KREU II**  
**SELIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, DEGËT DHE ZYRAT E**  
**PËRFAQËSIMIT, PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE**

**Neni 5**  
**Selia**

1. Selia e Shoqërisë është në adresën: Autostrada Tiranë-Vorë km14.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë, si dhe mund të vendosë hapjen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të saj.

**Neni 6**  
**Objekti i Shoqërisë**

1. Shoqëria, në mënyrë që të gjenerojë energji elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, ka për objekt të veprimtarisë ndërtimin dhe vënien në funksion të gjeneruesve të erës që prodhojnë energji elektrike, si dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar.
2. Për të arritur këtë qëllim, shoqëria do të operojë në fushat e mëposhtme, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e energjisë:
  - a) Marrjen përsipër të ndërtimit, shfrytëzimit, marrjen në kontroll, qerasë ose blerjes së gjeneruesve të erës në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose jashtë këtij territori, për qëllimin e prodhimit të energjisë elektrike. Njëkohësisht, nëse do të jetë e nevojshme, shoqëria do të kryejë procedurat për marrjen e licencave për prodhimin e energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  - b) Blerjen, shitjen, qiradhënien, prodhimin, instalimin, importimin dhe eksportimin e pjesëve që janë të ndashme/të shkëputshme të gjeneruesve të erës, dhe nëse është e nevojshme, mirëmbajtjen dhe riparimin e gjeneruesve hidroelektrikë, gjeotermalë, solarë, eolikë apo turbinave të erës, në tërësinë e tyre, ose në pjesë të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  - c) Shitjen e energjisë elektrike dhe/ose kapaciteteve që prodhohen drejt entiteteve ligjore, mbajtëse të licencave të shitjes me shumicë dhe/ose të shitjes me pakicë, konsumatorëve që konsiderohen të përshtatshëm, ose shoqërive të tjera të ngjashme nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  - d) Shoqëria mund të marrë përsipër kryerjen/ ndërtimin e të gjitha llojeve të linjave të transmetimit të energjisë, ndërtimin e instalacionit dhe të infrastrukturës së nevojshme që

lidhet me fushën e saj të veprimit, nëpërmjet kontraktimit të palëve të treat në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 7

#### Kohëzgjatja e Shoqërisë

1. Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe është pa afat të caktuar.
2. Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë.

#### Neni 8

#### Përgjegjësia e Ortakëve

1. Ortakët e Shoqërisë janë Personat që kanë përfituar kuotën e tyre në Shoqëri në përputhje me kontributin e tyre. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

### KREU III

#### KAPITALI I REGJISTRUAR DHE KUOTAT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT, KALIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

#### Neni 9

#### Kapitali i Shoqërisë

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë ndahet midis Ortakëve në kuota në përputhje me kontributet përkatëse në kapital. Kontributi mund të jetë në para ose natyrë (*pasuri të luajtshme apo të paluajtshme apo të drejta të ortakëve*).
2. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është i barabartë me 300.000 Euro, ekuivalenti në Lekë në datën e shlyerjes së kapitalit të shoqërisë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët. Kapitali fillestar do të shlyhet përgjatë tre muajve duke filluar nga dita e regjistrimit të shoqërisë. Kapitali themeltar është i përbërë nga 3 kuota të cilat i përkasin Ortakëve:
  - 1) Hekuran BRAHIMAJ, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme prej 99.000 Euro që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - 2) Sefer Selim ERDEM, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme prej 99.000 Euro që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - 3) Fikret BANGU, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme prej 102.000 Euro që përbën 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga pasuri të tjera të dhëna ose që do të jepen të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.

FB

4. Ortakët kanë të drejtë të tërheqin fondet e depozituara si kapital themeltar të Shoqërisë, në rast se Shoqëria nuk regjistrohet ne Qendrën Kombëtare të Biznesit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e depozitimit të fondeve.

#### **Neni 10**

#### **Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar**

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

#### **Neni 11**

#### **Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar**


1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.
2. Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në bazë të ligjit ose të statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë ndryshe.

#### **Neni 12**

#### **Transferimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar**

1. Dispozitat e këtij neni të Statutit kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, unitetit të ortakëve dhe ekuilibrit të marrëdhënieve midis tyre dhe për këtë arsye vendosen kufizimet e mëposhtme, në rastin e transferimit të kuotave.
2. Transferimi i kuotave do të bëhet vetëm nëpërmjet një dokumenti në formë shkresore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
3. Në rast të transferimit të çdo forme të kuotave (përfshirë dhe transferimin pa kundër shpërblim), tek subjekte të ndryshëm, transferimi do të kushtëzohet nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga ortakët aktual të Shoqërisë, mbi kuotat të cilat synohet të transferohen, në përputhje me rregullat e përcaktuara në dispozitat vijuese.
4. Ortaku, që ka për qëllim të shesë apo të transferojë pjesëmarrjen e tij në kapital apo një pjesë të saj, duhet të njoftojë me letër rekomande ("Njoftimi i Transferimit"), ortakët e tjerë në adresën e selisë së Shoqërisë, në adresat e njoftuara prej tyre apo nëpërmjet postës elektronike email të komunikuar nga vetë ortakët. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat personale të transferuesit të kuotave dhe të përfituesit të tyre, vlerën e kuotave që do të transferohen, kushtet dhe afatet e transferimit, duke përfshirë çmimin ("Çmimi i Paracaktuar") dhe mënyrat e pagesës.
5. Njoftimi i Transferimit do të përcaktojë një afat ("Afati i Paracaktuar") i cili nuk do të jetë më pak se dhjetë (10) ditë nga data pasuese e Njoftimit të Transferimit të bërë, brenda së cilës oferta duhet të pranohet ose refuzohet. Njoftimi i Transferimit konsiderohet i përvokueshëm në momentin që është kryer.

6. Çmimi i Paracaktuar do të jetë një çmim i përcaktuar nga Shitësi dhe do të konsiderohet se reflekton një vlerë të drejtë të kuotës (që reflekton vlerën e aktiveve materiale e jo-materiale neto për çdo Kuotë të Shoqërisë).
7. Ortakët, të cilëve iu drejtohet njoftimi si më sipër, duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi pjesëmarrjen së cilës i referohet njoftimi duke i dërguar ortakut ofrues dhe Administratorit me letër rekomande brenda afatit të përcaktuar në njoftim, deklaratën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.
8. Në rast se ortakët e tjerë dhe ortakut transferues nuk bien dakord me Çmimin e Paracaktuar të kuotave të propozuar nga ky i fundit, ata do të caktojnë një ekspert për të përcaktuar çmimin sipas vlerës së tregut.
9. Vendimi i ekspertit nuk do të jetë detyrues për Shitësin, megjithatë në rast se Shitësi vendos të shesë me një çmim më të lartë se ai i vendosur nga eksperti/ët, Ortaku tjetër në diskrecionin e tij do të ketë të drejtë të blejë nga Shitësi kuotën/pjesën e kuotës duke u bazuar në procedurën e parashikuar në këtë dispozitë, ose t'i kërkojë Shitësit të përfshijë në propozimin e tij drejt blerësit të mundshëm edhe një pjesë ose të gjithë pjesëmarrjen e ortakut tjetër në Shoqëri me të njëjtin çmim. Çdo transaksion i kryer në shkelje të këtij paragrafi do të konsiderohet i pavlefshëm.
10. Në rast se në përfundim të Periudhës së Paracaktuar, nuk është marrë asnjë Njoftim Pranimi, ose jo të gjithë kuotat në Njoftimin e Transferimit janë pranuar nga Blerësi (t), Shitësi ka të drejtë të shesë Kuotat e tij tek një palë e tretë me një çmim jo më të ulët se Çmimi i Paracaktuar (dmth. duke përfshirë këtu çmimin më të lartë të përcaktuar nga Shitësi në kundërshtim me vendimin e ekspertëve në lidhje me Vlerën e Drejtë të Kuotës). Shitësi do të njoftojë paraprakisht me shkrim Ortakët e tjerë dhe Shoqërinë mbi identitetin e palës së tretë ("**Personi që synohet t'i transferohen kuotat**") të cilit ai synon ti shesë kuotat.
11. Sa më poshtë do të konsiderohet kusht paraprak mbi të drejtën e çdo Ortaku për të transferuar Kuotat drejt "**Personit që i transferohen kuotat**", pranimi i Ortakut(ëve) të tjerë me shkrim mbi transferimin e Kuotave drejt Personit që synohet ti transferohen;
12. Asnjë Ortak nuk mund të vendosë mbi kuotat ndonjë peng, garanci, apo çdo lloj barre tjetër apo t'i vendosë si objekt i një të drejte për t'i barrësuar pa marrë më parë miratimin me shkrim të shumicës së ortakëve. Asnjë Ortak nuk do të japë ndonjë opsion apo të drejtë për të disponuar ndonjë interes mbi kuotën që zotëron (përveç transferimit sipas parashikimeve të këtij neni). Asnjë Ortak nuk do të bëhet palë e një marrëveshjeje në lidhje me të drejtën e votës që lidhet me kuotën e tij apo letrave të tjera me vlerë që zotëron në Shoqëri dhe nuk do të japë ndonjë opsion në lidhje me to.
13. Në rast se një Ortak dëshiron të shesë, transferojë apo të disponojë kuotën e tij në përputhje me nën-pikat e këtij neni:
  - a) Shitësi do të paguajë të gjitha huatë, kreditë, detyrimet për të cilat Shitësi i detyrohet Shoqërisë (*bashkë me ndonjë interes të akumuluar*);
  - b) Ortaku (ët) e tjerë do të sigurohen se Shoqëria do të paguajë të gjithë huatë, kreditë, detyrimet për të cilat Shoqëria i detyrohet Shitësit (*bashkë me ndonjë interes të akumuluar*).



14. Çdo transferim i kryer në kundërshtim me rregullat dhe kufizimet e mësipërme do të konsiderohet i pavlefshëm dhe Ortaku transferues do të jetë përgjegjës ndaj Ortakëve të tjerë dhe Shoqërisë për dëmin e shkaktuar.
15. Të gjitha njoftimet në funksion të zbatimit të këtij neni do të bëhen me shkrim me letër të porositur (rekomande).

#### **Neni 13**

Fitimet e Shoqërisë i takojnë ortakëve të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

### **KREU IV ORGANET E SHOQËRISË**

#### **Neni 14**


#### **Asambleja e Përgjithshme**

Në bazë të ligjeve shqiptare dhe dispozitave të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortakët.

#### **Neni 15**

#### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe këtë statut, veçanërisht në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
  - m) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - n) anulimin e kuotave;
  - o) largimin ose përjashtimin e ortakut;
  - p) ndryshimin e logos të shoqërisë, markat tregtare;
  - q) çështje të tjera të parashikuara nga ligji nr. 9901/2008 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar apo nga ky statut.



2. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
3. Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
4. Administratori i shoqërisë zgjidhet dhe shkarkohet me 2/3 e votave të të gjithë ortakëve të shoqërisë.
5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 16**

##### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Adresa elektronike e-mail e ortakëve regjistrohet në dokumentet e Shoqërisë.
2. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
3. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 17**

##### **Vendimmarrja dhe kuorumi**

1. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja apo votimi në asamblenë e përgjithshme, mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Në këto raste është e nevojshme prania e Noterit. Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.
2. Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri.
3. Kuorumi i nevojshëm për të vendosur në asamblenë e zakonshme dhe/ose të jashtëzakonshme është ai i parashikuar në nenet 86, 87 të ligjit 9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

#### **Neni 18**

##### **Procesverbali i Mbledhjes**

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbajtësit të Procesverbalit, rezultatet e votimit.





2. Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbajtës Procesverbalit, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit.
3. Procesverbalit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

#### Neni 19

#### Pjesëmarrja përmes mjeteve elektronike

1. Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunikimit video-shkrues.
2. Përdorimi i mjeteve elektronike do të kryhet duke marrë të gjitha masat teknike të nevojshme për garantimin e identifikimit të ortakëve, si edhe sigurinë e këtyre mjeteve elektronike. Në veçanti është e nevojshme që:
3. Kryetari i Mbledhjes të ketë mundësinë të verifikojë dhe të identifikojë ortakët të cilët janë të pranishëm, të kontrollojë mbarëvajtjen e mbledhjes, të numërojë dhe të shpallë rezultatin e votimit;
4. Mbajtësi i procesverbalit të ketë mundësinë për t'u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura në mbledhjen, objekt të procesverbalit;
5. Të mundësohet pjesëmarrja e të gjithë të pranishmëve për të diskutuar mbi rendin e ditës, në shqyrtimin, marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha dokumenteve të përdorura gjatë mbledhjes si dhe në procesin e votimit mbi rendin e ditës.
6. Mbledhja e Asamblesë në kushtet e përmendura në nenin 18.1 dhe vijues të këtij Statuti, konsiderohet rregullisht e mbajtur pavarësisht faktit se Ortakët nuk janë të pranishëm në të njëjtin vend dhe kohë të konferencës në ditën dhe kohën në të cilën konferenca mbahet apo do të konsiderohet se u mbajt pranë selisë së Shoqërisë, nëse nuk bihet dakord ndryshe, të gjithë Ortakët që marrin pjesë në mbledhje do të konsiderohet se kanë qenë të pranishëm me kusht që vendimi të nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit të cilët duhet të jenë në të njëjtin vend gjatë mbledhjes.
7. Kryetari i Mbledhjes do të verifikojë identitetin e çdo ortaku pjesëmarrës ose përfaqësuesve të tyre.
8. Kuorumi i nevojshëm për telekonferencën do të jetë i njëjti kuorum i parashikuar në Statut për Asamblenë e Përgjithshme.
9. Në rast se ortakët janë të ftuar të marrin vendime nëpërmjet konsultimit me shkrim, kuorumi do të quhet si i formuar bazuar në numrin e ortakëve që do të dërgojnë votimin dhe vendimet e tyre me shkrim. Administratori ose çdo Ortak i pakicës që kërkojnë vendimarrjen duhet t'i dërgojnë çdo ortaku njoftimin për konsultimin me shkrim, i cili do të përmbajë gjithë informacionet që përfshihen në letrën e njoftimit/thirrjes të përcaktuar në këtë Statut. Procedura e konsultimit me shkrim duhet të kryhet në përputhje me përmbajtjen e këtij neni, në rastet kur zbatohet. Çdo ortak duhet të shprehet me shkrim në lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve në formën e dërguar nga administratori, nëpërmjet shënimit "pro" ose "kundër" ose duke u shprehur komentet e tyre në një dokument tjetër. Në rast se ortakët kanë komente, duhet t'u bëjnë referencë të qartë projekt-vendimeve. Secili ortak duhet t'i dërgojë Administratorit ose ortakëve që kanë kërkuar marrjen e vendimit nëpërmjet këshillimit me shkrim, votën e tij/vendimet me

FR

shkrim brenda datës së përcaktuar në njoftimin e dërguar për marrjen e vendimit nëpërmjet konsultimit me shkrim.

10. Vendimet e ortakëve të marra si dhe diskutimet dhe komentet e ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes të hartuar nga Mbajtësi i procesverbalit. Gjithashtu ky procesverbal duhet të pasqyrojë mënyrën e organizmit të mbledhjes së asamblesë apo të konsultimit me shkrim nëse është kryer në përputhje me ligjin dhe dispozitat e Statutit, të identifikojë ortakët e pranishëm dhe të përfaqësuar ose ortakët që kanë votuar me shkrim, nëse kuorumi i ortakëve që kanë votuar me shkrim është respektuar sipas Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe nëse vendimet konsiderohen të miratuara sipas rezultatit të votimeve. Procesverbali do të nënshkruhet nga Kryetari dhe Mbajtësi i procesverbalit. Procesverbalit i bashkëngjitet gjithashtu lista e ortakëve që kanë votuar (përveç rastit kur procesverbali është nënshkruar nga gjithë ortakët) si dhe njoftimi i thirrjes së asamblesë të cilat mbahen në selinë e Shoqërisë. Nëse vendimet e marra nga ortakët duhet të depozitohen pranë Regjistrat Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhëna (nëpërmjet konsultimit me shkrim nga ortakët) do të shërbejnë si dokumentet që provojnë të dhënat që do të depozitohen në këtë regjistër.
11. Në rast se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk mund të shqyrtojë në të njëjtën ditë të gjitha çështjet që duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do të bëhet të nesërmen pa pasur nevojë për njoftim të mëtejshëm.


## **Neni 20**

### **Administratori**

1. Administratori është organi ekzekutiv i Shoqërisë.
2. Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
3. Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të Shoqërisë. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët; të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë, si dhe t'i depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. Administratori do të jetë përgjegjës por pa u kufizuar për sa më poshtë:
  - a) Të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të Shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit; punësimin dhe pushimet nga puna të personelit; dhënien e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në Shoqëri; mbajtjen e korrespondencës së Shoqërisë; dhënien e autorizimit për blerjen, marrjen me qira etj., të mallrave apo shërbimeve të zakonshme të cilat lidhen në mënyrë direkte apo të tërthortë me punën e përditshme të Shoqërisë; autorizimin për kryerjen e transferimeve bankare apo tërheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e Shoqërisë lidhur me pagat apo shpërblimet e punonjësve të Shoqërisë; Të përpilojë dhe të nënshkruajë faturat tatimore që do të lëshohen në emër të Shoqërisë si rezultat i punëve të kryera; të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajë çdo dokument për kryerjen e pagesave bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të çdo lloji në llogaritë bankare të Shoqërisë, në të gjitha numrat e llogarisë të Shoqërisë, pranë çdo banke ku ndodhen këto llogari. Çdo dokument për kryerjen e



- pagesave bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të çdo lloji në llogaritë bankare të Shoqërisë, në të gjitha numrat e llogarisë të Shoqërisë, pranë çdo banke ku ndodhen këto llogari në mënyrë që të jetë i vleshfshëm, përveç nënshkimit të administratorit duhet të nënshkruhet dhe nga njëri nga ortakët e shoqërisë.
- b) Të përfaqësojë shoqërinë në lidhje me negocimin, hartimin dhe lidhjen e çdo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë apo juridikë vendas ose të huaj, me institucione apo ente të ndryshme shtetërore si dhe çdo subjekt tjetër. Çdo lloj marrëveshje tregtare e lidhur me persona fizikë apo juridikë vendas ose të huaj, me institucione apo ente të ndryshme shtetërore si dhe çdo subjekt tjetër, në mënyrë që të jetë e vlefshme duhet të jetë e nënshkruar përveç administratorit dhe nga njëri nga ortakët.
  - c) Të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - d) Të hartojë projekt planin e investimeve të Shoqërisë dhe ta paraqesë për miratim në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve;
  - e) Të caktojë pagat dhe shpërblimet e punonjësve dhe stafit tjetër ndihmës të shoqërisë në bashkëpunim me ortakët e kompanisë;
  - f) Të lidhë marrëveshje me palë të treta bashkëpunimi, investimi apo zhvillimi në funksion të interesit të shoqërisë, me kusht që të përveç nënshkimit të administratorit të nënshkruhet dhe nga njëri nga ortakët.
  - g) Të kryejë investime në interes të shoqërisë;
  - h) Të vendosë mbi planin operacional të Shoqërisë;
  - i) Të hartojë buxhetin financiar vjetor për t'u miratuar nga Asambleja e Ortakëve;
  - j) Ngritjen e sistemit të administrimit të brendshëm;
  - k) Të emërojë konsulentë të brendshëm e të jashtëm të fushave të ndryshme që i shërbejnë shoqërisë dhe ndihmojnë administratorin në ushtrimin e veprimtarisë së tij;
  - l) Çdo kompetencë tjetër të parashikuar nga Statuti i Shoqërisë.
5. Për administrimin e zakonshëm të Shoqërisë të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme me vendim të posaçëm, një herë në vit, përcakton shumën limit me të cilën Administratori mund të kryejë veprimet e sipërcituara.
6. Për administrimin e jashtëzakonshëm të Shoqërisë, e cila do të kalojë kompetencat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni dhe shumën limit mbi të cilën do të marrë vendim Asambleja e Përgjithshme sipas paragrafit 4 të këtij neni, Administratori do të kryejë veprime vetëm mbi bazën e një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme.
7. Administratori i parë i shoqërisë është Z. Fikret BANGU, i biri i Orhan, lindur në Vushtrri, Kosovë, më 23.02.1973, banues në Rr. "Marin Barleti nr.45", Vushtrri, Kosovë, identifikuar me kartën e identitetit nr. ID1087706 me nr.personal 1001761109, shtetas kosovar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar. i cili ushtron të gjitha veprimtaritë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.



## Neni 21

### Të drejtat e Shoqërisë


1. Shoqëria mund të themelojë shoqëri të reja, në kuadër dhe të lidhura me qëllimin dhe objektin e saj, dhe njëkohësisht të bëhet pjesë e shoqërive ekzistuese. Në kuadër të përmbushjes së qëllimit dhe objektit të saj, mund të marrë hua/kredi si brenda, ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe të ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme në kuadër të mirëpërdorimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Shoqëria ka të drejtën e shitjes, blerjes, operimit, hipotekimit, servitutit dhe çdo lloj të drejte dhe transaksioni tjetër të ngjashëm ligjor, që mund të kryhet në kuadër të së drejtës së pronësisë dhe të drejtave reale lidhur me të, në favor të shoqërisë dhe në lidhje me fushëveprimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Shoqëria mund të hapë agjenci, zyra përfaqësimi, degë dhe të angazhohet në aktivitete tregtare në lidhje me fushën e saj të veprimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Shoqëria mund të hyjë në marrëdhënie me shoqëri shqiptare ose të huaja, nëpërmjet marrëveshjeve që përputhen me objektin dhe veprimtarinë që kryen shoqëria në përmbushje të tij, si dhe të marrë pjesë në proceset e tenderimit shqiptare dhe/ose të huaja.
5. Shoqëria siguron organizimin e duhur teknik dhe administrativ të shoqërive ekzistuese ose atyre që do të themelohen, në të cilat ajo është themeluese ose pjesëmarrëse/ortake, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Shoqëria mund të themelojë shoqëri shqiptare ose të huaja, shoqëri kapitali, shoqëri me kapital të huaj, të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi dhe partneriteti të zakonshme ose për qëllime biznesi që lidhen me fushën e veprimit; të marrë pjesë në bashkëpunime dhe partneritete ekzistente, të blejë dhe të shesë kuotat/aksionet dhe obligacionet, për sa kohë ato nuk përfshihen në natyrën e shërbimeve apo aktiviteteve të investimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Shoqëria mund të aplikojë, zotërojë dhe transferojë markat tregtare, patentat, njohuritë, dhe të tjera të drejta industriale, si dhe të lidhë marrëveshje licencimi, në përputhje me qëllimin e saj dhe legjislacionin në fuqi.

## Neni 22

### Detyrat e Shoqërisë

Shoqëria ka për detyrë:

- 1) të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
- 2) të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
- 3) të sigurojë punonjësit e saj;
- 4) të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
- 5) të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkohen nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë së saj;
- 6) të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.



### Neni 23

#### Marrëdhëniet e punës

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi.
2. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj.
3. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

### Neni 24

#### Konfidencialiteti dhe Ruajtja e sekretit

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga Administratori i Shoqërisë.

### KREU V

#### EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

### Neni 25

#### Eksperti kontabël

Kur është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar nga Shoqëria.

### Neni 26

#### Viti financiar dhe bilanci vjetor

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
2. Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

### Neni 27

#### Shpërndarja e fitimeve

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:
  - 1) aktivet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - 2) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

**KREU VI**  
**RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

**Neni 28**

**Prishja dhe likuidimi i shoqërisë**

1. Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast prishje Shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.
2. Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
3. Likuiduesi/t do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Emërimi i likuiduesit/ëve dhe procesi i likuidimit do të kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

**KREU VII**

**MOSMARRËVESHJET**

**Neni 29**


**Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim dhe marrin këshillim me ndërmjetësimin e një konsulenti ligjor i cili ofron mundësi zgjidhje në interesin më të mirë të secilit prej tyre në takime dhe diskutime të përbashkëta. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

**Neni 30**

**Dispozita përfundimtare**

1. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Ky Akt themelimi-Statut u redaktua në 2 (dy) kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim dhe nen për nen dhe u nënshkrua nga ortakët në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.
3. Ngarkohet administrator Z. Fikret BANGU mbajtës i kartës së identitetit nr. ID1087706 ose personat e Autorizuar prej tij për të kryer të gjitha procedurat pranë QKR-së për regjistrimin e shoqërisë.



ORTAKËT

Z. Hekuran Brahimaj

Hekuran Brahimaj

Z. Sefer Selim Erdem

Sefer Selim Erdem

Z. Fikret Bangu

FIKRET BANGU